



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 19.4.2022

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 12 dhe 19 prill 2022, shqyrtoi projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë projektligj, znj. Anila Denaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Z. Besart Kadia, Zëvendësministër;
- Znj. Elira Demiraj, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit;
- Znj. Arjana Dyrmishi, Drejtore e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik;
- Z. Dildirus Vrioni, përfaqësues nga AIDA;
- Znj. Enejda Murataj, përfaqësuese nga AIDA.

II. Baza ligjore.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78, 81, pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës. Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.

- *Zhvillimet e deritanishme në sektorin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme.*

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë pjesën më të madhe të bizneseve që operojnë në tregun shqiptar. Këto ndërmarrje luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, për arsye se ndikojnë në rritjen e produktivitetit të ekonomisë, ofrojnë punësimin e pjesës më të madhe të forcës së punës, ndikojnë në shpërndarjen më të barabartë të të ardhurave dhe zhvillimin gjithëpërfshirës mes rajoneve.

Sipas statistikave të publikuara nga INSTAT-i, për vitin 2020:

- 99,8 % e ndërmarrjeve aktive janë NMV;
- 81,9 % e të punësuarve janë të punësuar në NMV;
- 79,7 % e shitjeve neto realizohen nga NMV;
- 74 % e investimeve kryhen nga NMV;
- 74,1 % e vlerës së shtuar realizohet nga NMV.

Sipas sektorëve, peshën më të madhe e përbëjnë NMV-të në sektorët e bujqësisë, tregtisë dhe industrisë.

Ligji nr.8597, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, i ndryshuar.

Ky ligj përcaktoi se në kategorinë e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) përfshihen ndërmarrjet me më pak se 250 të punësuar dhe që realizojnë një shifër afarizmi apo një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë. Ligji përcaktoi edhe kufijtë që kategorizojnë NMV-të si mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla apo ndërmarrje të mesme, në varësi të xhiros dhe numrit të punonjësve.

Me ndryshimet e vitit 2008, ndërmarrjet u kategorizuan në ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere dhe ndërmarrje të lidhura, në varësi të pjesës zotëruese të kapitalit dhe të të drejtave të votës së tyre në raport me ndërmarrjet e tjera. Gjithashtu, u shtuan rregulla për përcaktimin e numrit të të punësuarve në këto ndërmarrje, i cili shërben si bazë për kategorizimin e tyre.

Mbështetja financiare, sipas ligjit ekzistues, parashikohet të realizohet përmes:

- programeve dhe projekteve të mbështetjes financiare;
- garantimit të një pjese të riskut të kreditimit;
- programeve dhe projekteve të asistencës teknike;
- shërbimeve të informacionit e këshillimit;
- arsimimit e trajnimit profesional;
- programeve të nxitjes së punësimit;

- dhënies me qira të pasurive të paluajjtshme me pronësi shtetërore;
- mbështetjes me infrastrukturë;
- ngritjes së parqeve industriale dhe inkubatorëve të biznesit etj.

Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me donatorët dhe institucionet financiare të vendit ose të huaja, parashikohet të përmirësojnë sistemin e kreditimit të NMV-ve, përmes mekanizmave financiarë, si:

- krijimi i fondit të garantimit të kredive;
- nxitja e kreditimit;
- zgjerimi i rrjetit bankar etj.

Prioritet në masat mbështetëse u jepet NMV-ve që ushtrojnë veprimtari në sektorët e prodhimit, shërbimit, industrisë, eksportit, si dhe atyre që krijojnë më shumë vende të reja pune. Programet mbështetëse realizohen si nga njësitë e pushtetit qendror, ashtu edhe të pushtetit vendor.

Ligji nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”.

Ky ligj parashikoi krijimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), si një institucion buxhetor që mbështet, ndër të tjera, edhe NMV-të, për fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese. Mbështetja parashikohet të realizohet përmes hartimit e zbatimit të strategjive, nxitjes së progresit teknologjik, shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit, përmirësimit të kapaciteteve menaxheriale, futjes së teknologjisë së informacionit etj.

Nevoja për një ligj të ri.

Hartimi i një ligji të ri për ndërmarrjet e vogla e të mesme u bë i nevojshëm:

Së pari, për të zgjidhur problematikat e hasura gjatë periudhës 20-vjeçare të zbatimit të ligjit ekzistues, siç janë:

- Interes i ulët në skemat e bashkëfinancimit të AIDA-s;
- Mungesë informacioni nga bizneset;
- Mënyra e aplikimit nëpërmjet postës dhe jo në formë elektronike;
- Mungesa e shërbimeve mbështetëse;
- Mungesa e mbështetjes financiare direkte me grante për kërkime e zhvillim;
- Mungesa e programeve të financimit apo financimet e ulëta nga buxheti i shtetit në fushën e kërkimit, teknologjisë dhe inovacionit;
- Mangësitë ligjore për krijimin dhe zbatimin e fondit të konkurrueshmërisë.

Aksesi i kufizuar në financë pasqyrohet në treguesit si më poshtë:

- Vetëm 1 % e NMV-ve në vendin tonë përdorin grante buxhetore, duke qenë 3 herë më pak se mesatarja e rajonit;
- Vetëm 75 % e NMV-ve kanë llogari bankare.

Së dyti, për të reflektuar zbatimin e rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare, siç janë:

Komisioni European.

Komisioni European ka theksuar se niveli i financimit të NMV-ve në Shqipëri ka ardhur në rritje vitet e fundit. Megjithatë, ky nivel është i pamjaftueshëm për të nxitur zhvillimin e shpejtë të këtij sektori, për arsye të vështirësive për të marrë kredi në banka, si rrjedhojë e:

- Kostos së lartë të kredisë (normë e lartë interesi);
- Kërkesave të mëdha të bankave, veçanërisht për një nivel të lartë kolaterali.

Mbështetja buxhetore për teknologji, inovacion dhe kërkim shkencor është e kufizuar. Mbështetja për NMV-të realizohet vetëm nëpërmjet fondeve të AIDA-s dhe nuk ka mekanizma të tjerë për këtë qëllim. Për të siguruar një mbështetje më të madhe për NMV-të, Komisioni European rekomandon rishikimin e kuadrit ligjor.

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

OECD ka theksuar disa problematika lidhur me NMV-të, si:

- Niveli i ulët i edukimit financiar të bizneseve dhe publikut;
- Mungon një qasje e qartë strategjike për të trajtuar mangësitë;
- Aksesin në financë është i ulët.

Për të zgjeruar aktivitetin, për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, si dhe për të rritur konkurrencën e NMV-ve në treg, OECD rekomandon krijimin e mekanizmave të duhur ligjorë.

Banka Botërore.

Banka Botërore ka theksuar se huadhënia nga institucionet e mikrofinancës, veçanërisht në zonat rurale, është rritur vitet e fundit. Por, kjo rritje është e kufizuar. Ka vështirësi në aksesin e financimit për NMV-të.

Përveç përdorimit të disa instrumenteve financiare, si qiraja financiare, faktoringu etj, Banka Botërore rekomandon krijimin e një skeme të përhershme të garancisë nga ana e qeverisë, që të mbështesë biznesin për të marrë një tjetër hov në zhvillim.

Qëllimi, objektivat dhe risitë e projektligjit.

Qëllimi i projektligjit është përmirësimi i politikave shtetërore dhe kuadrit institucional rregullator për të mbështetur zhvillimin e NMV-ve.

Objektivat që parashikohen të realizohen me këtë projektligj janë:

- Rritja e mbështetjes për NMV-të me 50 %;
- Rritja e mbështetjes me teknologji të reja, nga zero aktualisht, në 50 % brenda vitit 2022;
- Rritja e numrit të ndërmarrjeve të reja, rritja e numrit të të punësuarve, si dhe futja e instrumenteve të reja financiare respektivisht me 10 %;
- Rritja e shkallës së përthithjes së granteve nga bizneset me 100 %.

Projektligji ruan të njejtin përkufizim për ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme (NMVM), duke qenë në përputhje me rekomandimin e fundit të Komisionit Europian. Kategoritë e NMVM-ve janë:

Nr.	Kategoritë e NMVM	Nr. i të punësuarve	Shifër afarizmi/bilanc vjetor
		<i>nr.</i>	<i>milionë lekë</i>
1	Mikrondërmarrje	0 deri 9	Jo më të madh se 10
2	Ndërmarrje e vogël	10 deri 49	Jo më të madh se 50
3	Ndërmarrje e mesme	50 deri 249	50-250
	Totali NMVM	0 deri 249	Jo më të madh se 250

Risitë kryesore të projektligjit janë:

Së pari, strukturohen dhe përcaktohen qartë masat mbështetëse shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme. Format e mbështetjes shtetërore janë:

- mbështetje financiare nga buxheti i shtetit;
- mbështetje financiare nga partnerët për zhvillim, vendas ose të huaj;
- garanci shtetërore të huas;
- shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Garancia shtetërore e huas jepet, nga Këshilli i Ministrave, për të mbështetur kreditimin e NMVM-ve. Procedurat për këtë garanci janë në përputhje me:

- legjislacionin në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar;
- parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit shtetëror, si dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjet vjetore të buxhetit.

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, përcakton fondin, sektorët, kushtet dhe kriteret për këtë garanci.

Shërbimet publike për NMVM-të jepen nga AIDA dhe orientohen drejt dhënies së informacionit, këshillimit, trajnimeve, zhvillimit profesional, shërbimeve metodologjike etj.

Së dyti, përcaktohet baza ligjore për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve, e cila mungon aktualisht.

Kjo strategji hartohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Strategjia përcakton vizionin, objektivat dhe prioritetet për zhvillimin e NMVM-ve, si dhe rolin përkatës të njëjësive të qeverisjes qendrore dhe vendore. Aktualisht, Këshilli i Ministrave ka miratuar strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021-2027.

Së treti, përcaktohet ngritja dhe funksionimi i organit këshillimor për NMVM-të.

Ky organ është Këshilli Konsultativ për Ndërmarrjet, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, me përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore. Ky organ jep mendime e këshilla për mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit.

Së katërti, vendosen rregulla transparente për raportimin lidhur me veprimtarinë vjetore të NMVM-ve.

Institucionet shtetërore raportojnë pranë AIDA-s për ecurinë e zbatimit të skemave të mbështetjes financiare dhe të mbështetjes publike për NMVM-të, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. AIDA paraqet raportin vjetor për veprimtarinë e NMVM-ve në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, brenda datës 30 qershor të çdo viti.

IV. Efektet financiare.

Mbështetja financiare me grante dhe shërbime të ndryshme (këshillime, trajnime etj) ndaj biznesit ndikon në rritjen e shpenzimeve të parashikuara në PBA 2022-2024, si më poshtë:

- Për vitin 2022, efekti në rritjen e shpenzimeve buxhetore është 51.5 milionë lekë, nga të cilat grante janë 50 milionë lekë dhe trajnime 1.5 milionë lekë.
- Për secilin prej viteve 2023 dhe 2024, efekti në rritjen e shpenzimeve buxhetore është 53 milionë lekë, nga të cilat grante janë 50 milionë lekë dhe trajnime 3 milionë lekë.

V. Diskutimi në Komision.

Z. Besart Kadia, Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, paraqiti projektligjin, duke vënë theksin në rolin që ai do të luajë në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Znj. Anila Denaj, në cilësinë e relatores, theksoi se projektligji vjen në një moment shumë të rëndësishëm të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, të cilat përbëjnë pjesën dërmuese të biznesit në vendin tonë. Ky projektligj do të rrisë mbështetjen ndaj NMVM-ve, duke rritur aksesin në investime dhe grante, me qëllim rritjen e vlerës dhe forcimin e konkurrueshmërisë së tyre.

Mbështetja financiare do të shoqërohet edhe me masat mbështetëse shtetërore ndaj NMVM-ve, si këshillimet, trajnimet, rritja e aksesit në informacion etj. Këto masa pritet të sjellin përmirësim të kapaciteteve dhe aftësive për qeverisje të NMVM-ve, rritje të formalizimit, si dhe forcim të rregullave të brendshme dhe të të bërit biznes.

Mbështetja financiare dhe ajo përmes këshillimeve do të realizohen nga AIDA, roli i së cilës do të fuqizohet më tej. Mbështetja e biznesit, përmes këtij projektligji, bëhet në vijim të politikave mbështetëse të mëparshme, siç janë ndihmat dhe garancitë sovrane, të cilat jepen për të gjithë biznesin dhe jo vetëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Në aktet nënligjore, që do të hartohen më pas, fokusi për zhvillimin e NMVM-ve duhet të jetë në mbështetjen me prioritet të NMVM-ve që rrisin vlerën, zhvillojnë teknologjinë, rrisin produktivitetin dhe përmirësojnë cilësinë e prodhimit, për të konkurruar në tregun rajonal e më gjerë.

* * *

Gjatë diskutimit, Zëvendësministri i Financave dhe përfaqësuesit e tjerë të kësaj ministrie, me kërkesë të anëtarëve të Komisionit, paraqitën informacionet si më poshtë:

Së pari, lidhur me fondet e dhëna ndër vite për NMV-të.

Gjatë periudhës 2014-2019 kanë aplikuar 531 NMV, nga të cilat kanë përfituar 373 NMV. Numri i NMV-ve përfituese, sipas llojit të fondit, është :

- Fondi i konkurrueshmërisë 126;
- Fondi i ekonomisë kreative 77;
- Fondi i sipërmarrjeve të reja 95;
- Fondi i inovacionit 62;
- Fondi për zonat historike 13.

Në buxhetin 2022 fondi i mbështetjes buxhetore për NMV-të është 105 milionë lekë, me një rritje të ndjeshme në krahasim me vitet e mëparshme.

Së dyti, lidhur me pyetjen se a krijon ky projektligj mekanizmin e duhur për të siguruar një konkurrencë të drejtë në ndarjen e fondeve midis ndërmarrjeve të vogla e të mesme:

Mekanizmi sipas skemës së re rrit konkurrueshmërinë ndërmjet NMVM-ve, për arsye se:

- Skema e aplikimit nga NMVM-të për përfitimin e granteve, do të ndryshojë nga aplikim nëpërmjet postës, në aplikim në formë elektronike. Kjo skemë e re do t'u krijojë të gjitha NMVM-ve akses të njëjtë në përfitimin e granteve, pararendisht nga vendndodhja e biznesit.
- Do të përmirësohet dhënia e informacionit për NMVM-të që duan të aplikojnë, nëpërmjet projekteve, për përfitimin e fondeve nga buxheti apo nga donatorët vendas ose të huaj. Ky informacion do të pasqyrohet i plotë dhe i detajuar, në formë elektronike, duke rritur aksesin në financë të NMVM-ve. Ky proces do të kryhet me ndihmën e BERZH-it dhe do të zbatohet nga AIDA.
- Projektligji përcakton procedurat për dhënien e aksesit në financë ndaj NMVM-ve. Kriteret për përfitimin e granteve do të përcaktohen në VKM-të që po hartohen aktualisht. Kriteret do të jetë të tilla, që të mos e lejojnë të njëjtin subjekt që të aplikojë çdo vit, dmth të abuzojë apo të marrë më shumë fonde se disa subjekte të tjera. Këshilli konsultativ për NMV-të do përcaktojë sektorët që do të mbështeten me prioritet. Shoqatat e biznesit do të propozojnë vetë përfaqësuesit e tyre në Këshillin Konsultativ për NMVM-të. Fokusi kryesor do të jetë tek NMVM-të që punojnë në sektorin e eksportit, për t'i bërë të konkurrueshme me rajonin, duke respektuar edhe rekomandimet e OECD-së.

Së treti, lidhur me instrumentet që do të realizojnë menaxhimin dhe monitorimin e fondeve.

Instrumenti (ose institucioni) që do të realizojë menaxhimin e fondeve të buxhetit të shtetit, që do të përdoren për NMVM-të, në nivel qendror, është AIDA. Fondet buxhetore do menaxhohen nga institucionet buxhetore.

Meqenëse fondet për NMV-të nuk vijnë vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga pushteti vendor dhe donatorët, lindi nevoja për të forcuar marrëdhënien midis të gjitha strukturave. Për këtë arsye, projektligji përmirëson procedurat për mbledhjen e informacionit, raportimin dhe monitorimin e fondeve për NMV-të.

Të gjitha institucionet shtetërore do të raportojnë pranë AIDA-s për ecurinë e zbatimit të skemave mbështetëse për NMV-të, brenda datës 31 mars. AIDA do të paraqesë raportin vjetor në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, brenda datës 30 qershor.

Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është propozuar ndryshimi i strukturës, për të pasur një drejtori të posaçme që merret me nxitjen e biznesit, si dhe sektor të posaçëm për monitorimin dhe evidentimin e raporteve. Kjo drejtori do të monitorojë jo vetëm fondet e buxhetit të shtetit në nivel qendror, por edhe fondet që do të sigurohen nga pushteti vendor dhe nga donatorët për financimin e NMVM-ve.

Skema e raportimit dhe e mbikëqyrjes së fondeve për NMVM-të, si dhe e procedurave për shpërndarjen e tyre, do të plotësohet e detajohet më tej gjatë hartimit të akteve nënligjore, për të siguruar politika të qëndrueshme në zhvillimin e tyre dhe rritjen e punësimit.

Së katërta, lidhur me impaktin që do të sjellë projektligji në zgjerimin dhe fuqizimin e NMVM-ve, rritjen e konkurrueshmërisë, kreativitetit, inovacionit, mbështetjes së sektorit të bujqësisë dhe eksportit:

Fuqizimi i AIDA-s, si dhe rritja e rolit politikëbërës dhe monitorues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të ndikojnë në nxitjen dhe zgjerimin e NMVM-ve, si dhe rritjen e impaktit që ato pritet të japin në zhvillimin e ekonomisë.

Së pesta, lidhur me politikat fiskale për NMVM-të:

NMVM-të janë të përjashtuara nga taksat, ato nuk kanë rritje të çmimit të energjisë elektrike, ndryshe nga shumë biznese të tjera në rajon. Nuk parashikohet rritje taksash për to.

VI. Ndryshime në dispozitat e projektligjit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi edhe raportet e komisioneve të tjera që kanë dhënë mendim për projektligjin.

Komisioni për Integrimin Europian e ka miratuar projektligjin pa ndryshime, duke vlerësuar se është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kushtetutën, dhe legjislacionin në fuqi. Ky Komision ka vlerësuar se projektligji nuk përafrohet me legjislacionin detyrues të Bashkimit Europian, prandaj nuk ka sugjerime për ndryshime në dispozitat e tij.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin; Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; si dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat kanë paraqitur disa ndryshime e sugjerime në projektligj.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në përfundim, paraqet për shqyrtim në seancë plenare një variant integral të ndryshimeve në projektligj, si më poshtë:

Kudo në tekstin e projektligjit, fjalët “Qendra Kombëtare e Biznesit” të zëvendësohen me fjalët “Regjistri Tregtar”.

Neni 2

Neni 2 i projektligjit, në funksion të qartësisë në përmbajtje, të riformulohet si më poshtë:

“Qëllimi

“Qëllimi i këtij ligji është krijimi një kuadri rregullator ligjor dhe institucional për përkufizimin dhe kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si dhe për përcaktimin e politikave shtetërore që zbatohen në mbështetje të tyre”.

Neni 3

Në nenin 3 të bëhen këto ndryshime:

- *Për teknikë legjislative, prapa çdo përkufizimi*, sipas kuptimit, të shtohen fjalët “është”, “janë” dhe “do të thotë”.

- *Pika 6* të riformulohet si më poshtë:

“6. “NMVM” janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, që janë regjistruar në regjistrin tregtar, në të cilat me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 7, të këtij neni, organet publike, direkt ose indirekt nuk mund të zotërojnë më shumë se 25% të kapitalit apo të të drejtave të votës. “Ndërmarrje të reja” janë ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme, të cilat janë regjistruar në regjistrin tregtar prej jo më shumë se 12 muajsh.”.

- *Në pikën 7, shkronja “c”*, të riformulohet si më poshtë:

“c) investitorët institucionalë, përfshirë fondet rajonale të zhvillimit, në përputhje me legjislationin në fuqi për zhvillimin rajonal dhe kohezionin;”.

- Duke qenë se “Ndërmarrjet e lidhura” përfshihen në përmbajtjen e “Ndërmarrjes partnere”, *pika 8 të jetë pika 9, dhe anasjelltas*.

Neni 4

Në nenin 4, pas pikës 4 të shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Nëse një ndërmarrje nuk përmbush njëkohësisht kriteret e vendosura për kategoritë përkatëse të NMVM-ve, sipas pikave 1 deri në 4 të këtij neni, kategorizimi bëhet mbi bazën e numrit të personelit”.

Neni 10

Shkronja “c” e këtij neni të riformulohet si më poshtë:

“c) garanci shtetërore të huas, në përputhje me legjislacionin në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë, parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit shtetëror, si dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huas, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjet vjetore të buxhetit”.

Neni 11

Në nenin 11, pika 4 të riformulohet si më poshtë:

“Krijimi, funksionimi dhe shpërblimi i anëtarëve të bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedura konkurruese për dhënien e granteve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”;

Neni 17

- *Në nenin 17 të projektligjit dhe në tekstin e projektligjit në tërësi, për teknikë legjislativë, të përshtatet/unifikohet sipas fushave “ministri përgjegjës”.*

- *Pika 2 të riformulohet si më poshtë:*

“2. Këshilli kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe përbëhet nga 11 anëtarë me eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vite në fushën e ekonomisë dhe në mbështetjen e zhvillimit të biznesit, si më poshtë:

- a) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë;
- b) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes;
- c) 1 përfaqësues nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
- ç) 1 përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;

- d) 3 përfaqësues të sipërmarrjes dhe biznesit, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat më të përfaqësuara të tregtisë dhe biznesit;
- dh) 1 përfaqësues nga Shoqata e Bankave;
- e) 2 përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, nga të cilët një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe një përfaqësues nga institucionet jopublike të arsimit të lartë.
Përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë propozohen nga ministri përgjegjës për arsimin, pas përzgjedhjes me thirrje publike.
- ë) 1 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të propozuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.”.

- *Pika 3 të riformulohet si më poshtë:*

“3. Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, pas propozimit nga institucionet apo organizatat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.”.

- *Në pikën 4, shkronja “c” fjala “strategjisë” të zëvendësohet me fjalët “Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve”.*

Neni 18

Në pikat 1 dhe 2 të këtij neni fjalët “brenda një viti” të zëvendësohen me fjalët “brenda 3 muajve”.

Neni 19

Në fillim të fjalisë, të shtohen fjalët “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji,” .

VII. Përfundim.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se projektligji është në përputhje me kushtetutën dhe respekton procedurat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit. Komisioni e miratoi projektligjin me shumicë votash, me ndryshimet e paraqitura më lart.

RELATORJA

Anila DENAJ

KRYETARI

Eduard SHALSI